

VENDIM
Nr. 683, datë 14.11.2018

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË TE BASHKIA TIRANË, TË NJË PJESE TË
PASURISË SË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, NR. 4/258, TË “ALBA FILM” SHA,
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shetëtorore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2003, “Për pasuritë e paluajtshme shetëtorore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Bashkia Tiranë, të një pjese të pasurisë shetëtorore, me nr. 4/258, të shoqërisë “Alba Film” sh.a., të llojit “truall”, me sipërfaqe 909.5 m², në zonën kadastrale 8130.

2. Vendimi nr. 79, datë 17.2.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të disa mjediseve të “Alba Film Studio” sh.a. nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve te Ministria e Brendshme”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Bashkia Tiranë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi